



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 78/7 prot.

Tiranë, më 27.2.2025

V E N D I M

Nr.3, datë 27.2.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË ECURISË
DISIPLINORE, NË NGARKIM TË NËPUNËSES DILJOLA MEKO,
INSTITUCIONI BASHKIA KOLONJË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 78 prot., datë 20.1.2025, të dërguar nga nëpunësja Diljola Meko,

VËREJ SE:

Në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, me urdhrin nr. 8 (nr. 118 prot.), datë 9.1.2025 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për zj. Diljola Meko”, të Kryetarit të Bashkisë, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme për punonjësen Diljola Meko, me detyrë “Specialiste”, në Drejtorinë e Financës.

Më tej, nëpunësja parashton se, ky akt është në nxjerrë në kundërshtim me kërkesat materiale dhe procedurale të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të specifikuara në kapitullin që rregullon institutin e disiplinës në shërbimin civil në këtë ligj.

Për këtë arsye, nëpunësja i është drejtuar me shkresën e datës 10.1.2025, Kryetarit të Bashkisë, duke parashtruar se, akti i nxjerrë nga ky organ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në kreun X “Disiplina në

shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; përcaktimet e VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014 “*Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, të DAP.

Sipas informacionit të përcjellë nga nëpunësja në fjalë, rezulton se, Kryetari i Bashkisë nuk i ka dhënë një përgjigje zyrtare kësaj kërkesë dhe në këto rrethna, ajo ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e titullarit të institucionit.

Në këto rrethana, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Diljola Meko, ka nisur procesin e verifikimit paraprak të informacionit nëpërmjet shkresës nr. 78/2 prot., datë 24.1.2025, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 78 prot., datë 20.1.2025*”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të veprimit administrativ që është realizuar në këtë rast, si dhe duke i kërkuar njëkohësisht edhe dokumentacionin e plotë në të cilën është materializuar i gjithë procesi i largimit nga puna.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, me shkresën nr. 451/1 prot., datë 29.1.2025, e (protokolluar me nr. 78/3 prot., datë 31.1.2025), me lëndë: “*Kthim përgjigje*”, institucioni ka kërkuar shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, duke mos përcaktuar një afat konkret, me justifikimin se personi përgjegjës që administron aktet është duke kryer lejen vjetore dhe është jashtë shtetit për arsye shëndetësore.

Duke analizuar përmbajtjen e shkresës, të evidentuar më sipër, si edhe faktin se dokumentacioni i kërkuar administrohet njëkohësisht si në dosjen e personelit të punonjësës, ashtu edhe në Zyrën e Protokollit të institucionit, Komisioneri nuk e vlerësoi si të arsyeshme kërkesën për shtyrje afati dhe nëpërmjet autorizimit nr. 78/4 prot., datë 31.1.2025, ka dërguar një grup inspektimi, në institucionin e Bashkisë Kolonjë i cili u paraqit në datën 4.2.2025, për të verifikuar rrethanat dhe për të administruar dokumentacionin e nevojshëm për hetimin administrativ të këtij rasti.

Në zbatim të urdhrit të Komisionerit, grupi i punës është paraqitur në subjekt, në datën e caktuar dhe sipas procesverbalit administrativ të mbajtur në datën 4.2.2025 ka administruar dokumentacionin në vijim:

- Aktin e emërimit nr. 5520 prot., datë 13.11.2023, të njësisë përgjegjëse, për emërimin e punonjësës Diljola Meko, në pozicionin “*Specialist për planifikimin e punëve publike*”, Drejtoria e Shërbimeve, Bashkia Kolonjë;

- Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 5560 prot., datë 25.11.2024, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “*Specialist finance*”, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Kolonjë;
- Vendimin nr. 5567 prot., datë 25.11.2024 “*Për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil zj. Diljola Meko*”, për transferimin e nëpunëses në pozicionin “*Specialist për asetet dhe inventarët*”, Drejtoria Ekonomike, Financës dhe Buxhetit;
- Urdhrin nr. 8 (nr. 118 prot.), datë 9.1.2025 “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për nëpunësen Diljola Meko*”, të Kryetarit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për nëpunësen Diljola Meko;
- Aktin e miratimit të lejes vjetore datë 10.1.2025, për nëpunësen Lirika Butka, me detyrë “*Drejtore të Burimeve Njerëzore*”;
- Strukturën organizative të Drejtorisë së Financës dhe listprezencën e muajit Janar 2025.

Nëpërmjet këtij procesverbali, është evidentuar edhe fakti se, në dosjen e personelit të nëpunëses në fjalë, nuk gjenden akte që të provojnë zhvillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të saj, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Sipas akteve të administruara rezulton se, nëpunësja Diljola Meko, gëzon statusin e nëpunëses civile në kategorinë ekzekutive, sipas aktit të deklarimit nr. 5560 prot., datë 25.11.2024, të njësisë përgjegjëse. Nëpërmjet aktit nr. 8 (nr. 118 prot.), datë 9.1.2025 “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për zj. Diljola Meko*”, të Kryetarit, punonjëses në fjalë i është ndërprerë marrëdhënia e punës me institucionin me motivacionin: për sjellje jo etike me eprorin.

Komisioneri vlerësoi ligjshmërinë e nxjerrjes së këtij akti dhe procedurës së ndjekur në dhënien e kësaj mase disiplinore dhe ka arritur në përfundim se, nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument shkresor që të pasqyrojë veprimet administrative të kryera, gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses, nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vlerësimit të shkeljes së pretenduar, vënies në dijeni me shkrim të nëpunëses, seancën dëgjimore, deri në nxjerrjen e aktit final për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Kryetari i Bashkisë Kolonjë, ka vepruar në mungesë të kompetencës ligjore dhe procedurale për të nxjerrë një akt për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, e si rrjedhim në zbatim të germës a), i) dhe ii), të nenit 108 “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm, ç’ka duhet të konstatohet nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ të këtij rasti, nëpërmjet shkresës nr. 908 prot., datë 21.2.2025, (protokolluar me shkresën nr. 78/5 prot., datë 25.2.2025), nga ana e institucionit, Komisioneri është informuar për faktin se Kryetari i Bashkisë me aktin nr. 55

(nr.726 prot.) datë 10.2.2025, “Për revokim të Urdhrit nr. 8, datë 9.1.2025 dhe rikthimin në punë të nëpunës Diljola Meko”, ka urdhëruar revokimin e urdhrit nr. 8 (nr.118 prot.), datë 9.1.2025 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për zj. Diljola Meko”, nëpërmjet të cilit është ndërprerë marrëdhënia e punës për nëpunësen Diljola Meko; rikthimin në punë të nëpunës dhe fillimin e marrëdhënieve financiare në datën 11.2.2025.

Sa më sipër, konstatohet se, vetë organi që ka nxjerrë aktin e ka revokuar atë, e në këtë mënyrë ka rregulluar situatën, duke rikthyer ligjshmërinë në administrimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil për nëpunësen Diljola Meko, me detyrë “*Specialiste Finance*”, në Bashkinë Kolonjë.

Sa më sipër, në kushtet kur, akti nr. 8, datë 9.1.2025, me të cilin është vendosur përfundimi i marrëdhënieve të punës në shërbimin civil për nëpunësen Diljola Meko, është revokuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe janë rregulluar pasojat e ardhura duke e rikthyer nëpunësen në pozicionin e punës ku ka emërimin e rregullt, vlerësoj se, mungon objekti për verifikimin e mëtejshëm të rastit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 e 25 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit nr. 78 prot., datë 20.1.2025, të paraqitur nga nëpunësja Diljola Meko dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Kolonjë dhe nëpunësja Diljola Meko.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha